

Nr. Prot. 059/B/17**VENDIMI Nr. 1059**

Për
‘Ndryshimin dhe Plotesimin e Vendimit Nr. 1032
Për
‘Caktimin e bllokut numerik Jo-Gjeografik (mobil) nga seria
(0)45 7xx xxx
për përdorim nga DARDAFON.net LLC
(Ref. Nr. Prot. 049/B/17; dt.07/07/2017)’

Në mbështetje të nenit 45 paragrafi 1) dhe 3), nenit 58, nenit 59, paragrafi 1) dhe neni 79, paragrafi 1) dhe 2) i Ligjit Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike (*tutje referuar si - Ligji*); Rregullores Nr. 32 për Planin Kombëtar të Numeracionit për Rrjetet e Komunikimeve Elektronike në Republikën e Kosovës (*Ref. Nr. Prot. 038/B/17*), nenit 4), nenit 5), nenit 6), nenit 8) dhe nenin 16) (*tutje referuar si - Plani i Numeracionit*); në bazë të kërkesës së “DARDAFON.net” L.L.C (*tutje referuar si - DARDAFON*) të datës: 20/09/2017 (*Ref.Nr.Prot.615/2/17*) dhe nenit 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit (*Ref. Nr.Prot.054/B/17*) të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si - ARKEP ose Autoriteti*), Bordi i Autoritetit në përbërje prej:

- | | |
|----------------------|---------|
| 1) z. Kreshnik Gashi | Kryetar |
| 2) z. Bahri Anadolli | Anëtar |
| 3) z. Hazir Hajdari | Anëtar |
| 4) z. Nijazi Ademaj | Anëtar |

në mbledhjen e 22-të me radhë të mbajtur më datë 18 Tetor, 2017 pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, rekomandimit të paraqitur nga Departamenti i Komunikimeve Elektronike (DKE) dhe Departamenti Ligjor (DL), vendosi si më poshtë:

VENDIM

- I. Aprovohet kërkesa e **DARDAFON** për ndryshimin e bllokut numerik si në vijim:
 - Zëvendësohet blloku numerik (0) 45 700 000 – (0) 45 799 999, i caktuar në paragrafin I të Vendimit nr.1032 me bllokun **(0)46 100 000 – (0)46 199 999**.
- II. Të gjitha dispozitat tjera të aktvendimit bazë (*Ref.Vendimi Nr.1032, Nr.Prot. 049/B/17;07/07/2017*), mbeten të pandryshuara.
- III. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Me datën 20/09/2017 DARDAFON ka paraqitur kërkesë (nr. prot. 615/2/17) për zëvendësimin e bllokut numerik nga (0)45 700 000 – (0)45 799 999 në (0)46 100 000 – (0)46 199 999, i cili ka qenë i caktuar për përdorim të DARDAFON me Vendimin nr. 1032 të ARKEP.

Dardafon.net LLC dhe Telekom i Kosovës kanë njoftuar ARKEP se përkundër angazhimit maksimal të dyja ekipeve teknike (MNO dhe MVNO) nuk kanë arritur t'i diferencojnë numrat e MVNO dhe MNO në rangun 045 7xx xxx, si dhe rreth 3% e përdoruesve të këtij rangu janë në shfrytëzim nga përdoruesit e Telekomit të Kosovës. Duke pas parasysh vështërsitë e paraqitura në implementimin e këtyre numrave që të dyja palët janë dakorduar që MVNO të aplikojë për një rang tjetër të numeracionit. Prandaj, Dardafon me dt. 20/09/2017 ka aplikuar për zëvendësimin e numeracionit nga seria ekzistuese në serinë 046 1xx xxx. Njëkohësisht, edhe Telekom i Kosovës ka aplikuar (nr. prot. 702/2/17) për caktimin e numeracionit nga seria 045 7xx xxx.

Ligji, respektivisht neni 59, paragrafi 1) përkufizon se numrat, seritë numerike, mund të përdoren vetëm në bazë të vendimit të Autoritetit. Rrjedhimisht asnjë ndërmarrës i përfshirë në një veprimtari të komunikimeve elektronike në Republikën e Kosovës, operator dhe/apo ofrues i shërbimit universal nuk mund të përdorë një numër-at apo seritë numerike përveç nëse dhe derisa ARKEP t'i caktojë (akordojë) apo vazhdojë autorizimin për përdorimin e numrave të tillë.

Në bazë të Planit të Numeracionit, nenit 16, seria 4x e numrave është e përcaktuar si seri e numeracionit jo-gjeografik për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile.

Në bazë të Planit të numeracionit neni 16 paragrafi 5 përcaktohet se: Blloqet e numrave për shfrytëzim nga ofruesit e shërbimeve mund t'u caktohen operatorëve të rrjetit ose direkt ofruesit të shërbimeve, kurse në bazë të paragrafit 6 të këtij neni përcaktohet se: Pagesa vjetore për numeracionin e caktuar për operatorët dhe ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike në emër të shfrytëzimit kryhet nga shfrytëzuesi.

Në bazë të nenit 4 (*Kriteret për Caktim të Numrave*), paragrafi 2) pika b), përcaktohet që ndërmarrësit e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike janë të obliguar të aplikojnë tek Autoriteti "*për ndryshimin, ndërprerjen e numrit/serive numerike*".

Atëherë, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

Prishtinë, 24/10/2017

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Kreshnik Gashi
Kryetar i Bordit

Aktvendimi i dërgohet:

- Dardafon.net L.L.C;
- Departamentit të Komunikimeve Elektronike, ARKEP;
- Departamentit Ligjor, ARKEP; dhe
- Arkivit